

RREGULLORE NR.2000/7

**AMENDANMENT I RREGULLORES NR. 1996/16 TË UNMIK-UT PËR THEMELIMIN E
ORGANIT QENDROR FISKAL TË KOSOVËS
DHE ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME TË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren 2000/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të datës 14 janar 2000 mbi Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative në Kosovë,

Me shpalljen e Rregullores nr. 1999/16 të datës 6 nëntor 1999 për Themelimin e Organit Qendror Fiskal të Kosovës dhe çështje të tjera lidhur me të,

Me qëllim të miratimit të veprimeve të Organit Qendror Fiskal Brenda Strukturës së Përbashkët të Përkohshme të Kosovës,

Me anë të kësaj i ndryshon nenet 1, 2, 3, 4, 6 dhe 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/16.

Rrjedhimisht, Rregullorja nga data kur do të hujë në fuqi do ta ketë këtë formulim:

RREGULLORE NR. 1999/16

**PËR THEMELIMIN E ORGANIT QENDROR FISKAL TË KOSOVËS
DHE ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME TË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh ndryshimet e bëra në Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të themelimit të Organit Qendror Fiskal të Kosovës dhe çështjeve të tjera lidhur me të,

Shpall sa vijon:

Neni 1
Organi Qendror Fiskal

1.1. Organi Qendror Fiskal, duke vepruar sipas autorizimeve të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, është përgjegjës për udhëheqjen e përgjithshme financiare të buxhetit të Kosovës dhe buxheteve që janë në përgjegjësinë e komunave, të cilat së bashku formojnë Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Ky buxhet do të zhvillohet, miratohet dhe do të realizohet veçmas nga buxheti i Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të cilin e miraton Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

1.2 Organi Qendror Fiskal do t'i zbatojë direktivat e linjave të veprimit të formuluar nga Këshilli i Përkohshëm Administrativ nën udhëheqjen financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Neni 2
Funksionet

2.1. Organi Qendror Fiskal, pas konsultimit me personat përgjegjës qendrorë dhe komunalë, mund t'i bëjë rekomandime për linjat e veprimit Këshillit të Përkohshëm Administrativ përmes zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik, Rimëkëmbje dhe Zhvillim, mes tjerash, lidhur me:

(a) formulimin e një strategjie të përgjithshme fiskale për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, në dritën e kushteve makroekonomike dhe ndikimin të cilin politika fiskale mund ta ketë në kushtet ekonomike;

(b) zhvillimin e të hyrave publike dhe programin e shpenzimeve për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe formulimin e planeve për kontrollin dhe realizimin e shpenzimeve sipas programit të hyrave dhe shpenzimeve;

(c) formulimin e linjave të veprimit për krijimin dhe mbledhjen e të hyrave, duke përfshirë taksat direkte dhe indirekte, taksat doganore dhe akcizat, tatimin e shitjes, pagesat e shërbimeve dhe kontributeve të donatorëve dhe jo vetëm këto;

(d) kontrollimin dhe realizimin e mbledhjes së të hyrave dhe shpenzimin e tyre në pajtim me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës;

(e) krijimin e marrëveshjeve adekuate të kontrollit të brendshëm financiar për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe,

(f) udhëheqjen e llogarive bankare të Fondit të Konsoliduar të Kosovës.

2.2 Organi Qendror Fiskal do të:

(a) zhvillojë Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe do t'ia prezentojë këtë buxhet Këshillit të Përkohshëm Administrativ për miratim përmes zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik, Rimëkëmbje dhe Zhvillim dhe, sipas nevojës, ia paraqitet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për shqyrtim dhe miratim me rregullore;

(b) garantojë zhvillimin dhe miratimin e buxheteve të komunave dhe realizimin e tyre nga ana e administratorit komunal në mënyrën e cila është në pajtim me kushtet e vlerësuara makroekonomike dhe me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës;

(c) koordinojë me departamentet tjera administrative çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e Buxhetit Kapital/Investues dhe integrimin e këtij buxheti me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës;

(d) koordinojë aktivitetet e agjencive ndërkombëtare dhe qeveritare dhe të organizatave joqeveritare për zhvillimin dhe realizimin e marrëveshjeve të dhurimeve dhe ndihmave financiare të donatorëve;

(e) regjistrojë dhe do t'i raportojë Këshillit të Përkohshëm Administrativ për shpenzimet dhe të hyrat e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, përmes zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik, Rimëkëmbje dhe Zhvillim;

(f) kujdeset për krijimin e një mjedisi teknologjik informativ për të mbështetur funksionet e veta dhe

(g) kryejë aso funksione që varen nga ato të parashtuara më lart në këtë nen dhe të cilat i janë caktuar Organit Qendror Fiskal nga ana e zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik, Rimëkëmbje dhe Zhvillim.

Neni 3

Bashkëdrejtuesit e Organit Qendror Fiskal

Bashkëdrejtuesit e Organit Qendror Fiskal, nën mbikëqyrjen e zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik, Rimëkëmbje dhe Zhvillim, do të jenë së bashku përgjegjës për:

(a) udhëheqjen e Organit Qendror Fiskal dhe zbatimin e funksioneve që i janë besuar atij.

(b) plotësimin me personel, organizimin dhe administrimin e Organit Qendror Fiskal dhe lëshimin e udhëzimeve administrative dhe drejtimin e direktivave për çdo çështje që ka të bëjë me funksionet e Organit Qendror Fiskal dhe

(c) udhëheqjen efektive dhe efikase të burimeve që i sigurohen Organit Qendror Fiskal nga ana e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës apo nga ndonjë burim tjetër.

Neni 4

Llogaritë e Buxheti të Konsoliduar të Kosovës

4.1 Viti fiskal është vit prej 12 muajsh, duke filluar më një janar dhe duke mbaruar më tridhjetenjë dhjetor të secilit vit kalendarik, përveç nëse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm vendos ndryshe.

4.2 Bashkëkryesuesi i Organit Qendror Fiskal i UNMIK-ut do të hapë dhe mbajë një apo më shumë llogari bankare për marrjen, ruajtjen, pagimin apo përcjelljen e mjeteve financiare të mbledhura a të pranuar, që kanë të bëjnë me buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

4.3 Mjetet financiare të mbledhura apo të pranuar e përbëjnë Fondin e Konsoliduar të Kosovës, pavarësisht se a janë marrë ato mjete fillimisht në shërbimet për pagesa me të holla të gatshme të Shërbimit Publik të Kosovës apo në llogaritë bankare. Sa i përket mjeteve të pranuar nga Fondi i Besur (Trust Fund) i KB-së për Misionin e Administratës së Përkohshme të KB-së në Kosovë, shpërndarjen dhe marrëveshjet për paraqitjen e raporteve lidhur me transferin, ato duhet të regjistrohen nga ana e kontrollorit të Kombeve të Bashkuara dhe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

4.4 Kurrfarë shpenzimesh nuk mund të bëhen nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës përveç mjeteve të caktuara të parapara me ndonjë rregullore të shpallur nga ana e Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara.

Neni 5
Revizioni i pavarur financiar

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të garantojë për vendosjen e marrëveshjeve adekuate për revizion të pavarur financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Revizorët duhet t'i raportojnë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 6
Personeli dhe politika e punësimit

Bashkëkryesut e Organit Qendror Fiskal do të:

- (a) zbatojnë politikë jodiskriminuese të personelit me qëllim që përbërja e personelit të OQF-së të pasqyrojë natyrën multietnike të bashkësive të Kosovës;
- (b) sigurojnë ekuilibrim të drejtë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet e Organit Qendror Fiskal dhe;
- (c) garantojnë se tërë punësimi është bazuar në një konkurrencë të haptë të kualifikimeve profesionale, aftësive dhe meritave.

Neni 7
Ligji në fuqi

Kjo rregullore do të shfuqizojë çfarëdo dispozite tjetër të ligjeve në fuqi që janë në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 8
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 18 shkurt 1999.

Bernard Kouchner
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm